

VENDIM
Nr.759, datë 15.9.2010

PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE, NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2010-2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 5 të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë", të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike dhe studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Përfitojnë bursë nxënësit dhe studentët, brenda kuotave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim:

2.1 Sipas kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

a) Nxënësit/studentët, që vazhdojnë studimet larg vendbanimit të tyre në largësinë mbi 5 km dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Nxënësit që banojnë në fshat, të cilët nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km e që vendosen në konvikt publik.

c) Nxënësit/studentët, që kanë përfutur statusin e jetimit dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

ç) Nxënësit/studentët të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

d) Secili nga studentët bashkëshort me fëmijë, që plotëson kriterin ekonomik dhe që vendoset në konvikt publik.

dh) Fëmijët, nxënës apo studentë, që kanë statusin e invalidit, paraplegjikut dhe tetraplegjikut dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

2.2 Sipas rezultateve të arritura (nxënës/studentë):

a) Nxënësit e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

b) Nxënësit të cilët vazhdojnë studimet në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore dhe ndërtim, në vitet e dyta e lart, dhe që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë).

c) Studentët që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që kanë mbaruar shkollën e mesme me Medalje Ari.

ç) Studentët që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që janë shpallur nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës më të mirët e Maturës Shtetërore, sipas renditjes në listën e vlerësimit. Për vitin 2010, numri i tyre do të jetë 25 (njëzet e pesë) studentë. Kjo kategori

studentësh përfiton bursë kur ata vazhdojnë studimet në institucionet e arsimit të lartë publik dhe vetëm për vitin shkollor 2010-2011.

d) Studentët që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

dh) Studentët që vazhdojnë studimet në specialitetin matematikë dhe në specialitetin fizikë, në vitet e dyta e lart, dhe kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë).

2.3 Jashtë kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

a) Fëmijët, nxënës apo studentë, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës. Në fillim të çdo viti akademik Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Mbrojtjes dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, listën për këtë kategori nxënësish/studentësh.

b) Nxënësit që vijnë nga zonat verilindore dhe juglindore të vendit (Tropoja, Hasi, Puka, Kukësi, Dibra, Bulqiza, Mati, Mirdita, Malësia e Madhe, Librazhdi, Gramshi, Kolonja, Përmeti, Pogradeci, Skrapari, Tepelena dhe rrethi Tiranë), të cilët regjistrohen dhe ndjekin studimet në vitin e parë shkollor 2010-2011, në shkollat e mesme profesionale.

2.4 Sipas degëve prioritare për zhvillimin e ekonomisë (nxënës):

Nxënësit që regjistrohen dhe të cilët ndjekin studimet në vitin e parë shkollor 2010-2011, në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinarë, pyjore, ndërtim dhe teknologji informacioni.

3. Nxënësit dhe studentët e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të bursës, kur:

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;

ç) shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalue.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes së bursave, për drejtoritë arsimore rajonale (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA), për vitet e para, sipas kuotave të miratuara (për nxënës/studentë). DAR/ZA-të, pas këshillimit me njësitë e pushtetit vendor, hartojnë planin e shpërndarjes së bursave dhe e dërgojnë në njësitë e pushtetit vendor (bashki/komunë), në përshtatje me kërkesat e paraqitura paraprakisht prej tyre për kategoritë, sipas pikës 2.1.

5. Bashkitë dhe komunat, bazuar në planin e përcaktuar për to nga DAR/ZA-të, vendosin, me këshillat e tyre, për dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij vendimi, duke u dhënë përparësi nxënësve dhe studentëve nga shtresat sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë ose, në pamundësi, trajtimin me gjysmë burse.

5.1 Bashkitë dhe komunat, detyrimisht, duhet t'u dërgojnë, në rrugë zyrtare, drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore përkatëse, vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

5.2 Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore duhet të dërgojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, si dhe bashkive/komunave që menaxhojnë konviktet, listën emërore të studentëve dhe të nxënësve bursistë, së bashku me vendimet origjinale të këshillave të bashkive dhe të këshillave të komunave. Një kopje e listës emërore të studentëve dhe nxënësve të trajtuar me bursë dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

5.3 Plani i bursave për nxënësit që regjistrohen dhe vazhdojnë studimet në vitin e parë shkollor 2010-2011, në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinarë, pyjore dhe ndërtim, jepet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), për bashkinë dhe komunën përkatëse, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve në të cilat janë vendosur nxënësit, sipas numrit të nxënësve të regjistruar në këto degë. Drejtoria Arsimore Rajonale dhe Zyra

Arsimore menjëherë, me mbarimin e regjistrimit në këto degë, dërgojnë informacion, në MASH, për numrin e nxënësve të regjistruar në këto degë.

6. Bursat e nxënësve, për vitet e dyta e lart, rishqyrtohen dhe miratohen, çdo vit, nga këshilli i bashkisë dhe i komunës, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktore.

Nxënësit që vitin e parë kanë përfituar bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës ku ata kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

7. Bursat e studentëve, për vitet e dyta e lart, rishqyrtohen dhe miratohen, çdo vit, nga institucionet e arsimit të lartë. Studentët e viteve të dyta e lart, që nuk kanë përfituar bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të planit të bursave, të përcaktuara sipas këtij vendimi.

Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët që përfitojnë bursë sipas pikës 2.2 është deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin 2010-2011. Institucionet e arsimit të lartë paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, kërkesat për studentët që përfitojnë bursë sipas pikës 2.2 të këtij vendimi “sipas rezultateve të arritura”.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes dhe e dërgon për ekzekutim në institucionet e arsimit të lartë. Studentët që vitin e parë kanë përfituar bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

8. Nga plani i bursave të miratuara për vitin shkollor 2010-2011, bashkisë së Tiranës i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) bursa për studentët që vijnë nga familjet/shtresat sociale në nevojë dhe janë invalidë, paraplegjikë e tetraplegjikë, pavarësisht nga kriteri i studimit larg vendbanimit, ndërsa bashkive të tjera, të cilat në vendndodhjen e tyre territoriale kanë institucione të arsimit të lartë publik, u jepen deri në 5 (pesë) bursa, për këtë kategori studentësh.

9. Nxënësit dhe studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përfitojnë falas veshmbathje, libra, fletore etj., sipas pasqyrës nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme, që ofrojnë shkollat.

9.1 Nxënësve dhe studentëve që kanë përfituar statusin e jetimit, u sigurohen falas, nga fondet e shkollave përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës dhe të kartës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

9.2 Nxënësit jetimë e përfitojnë bursën edhe gjatë pushimeve verore, si dhe vetëm një vit kur humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalue.

9.3 Fëmijët dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një vakt ushqim (drekë), me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë.

10. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për studentët administrohen nga institucionet e arsimit të lartë. Bursat paguhen çdo muaj me kalim në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti.

10.1 Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga bashkia e komuna, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktore. Bursa u jepet nxënësve me ushqim në konvikt.

10.2 Nxënësve, të cilët nuk janë vendosur/akomoduar në konvikt, për mungesë kapacitetesh, bursa u paguhet çdo muaj nga bashkia/komuna, në llogarinë bankare të

nxënësit/prindit përfitues, pranë bankave të nivelit të dytë apo në zyrat e Postës Shqiptare. Drejtorët e shkollave profesionale e socialkulturore dërgojnë, çdo muaj, pranë njësive të pushtetit vendor, frekuentimin e shkollës për nxënësit që përfitojnë bursë.

11. Niveli i bursës, për nxënësit dhe studentët, jepet sipas pasqyrave nr.2 e nr.3 dhe kuota financiare ushqimore ditore jepet sipas pasqyrave nr.4 e nr.5, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Drejtuesit e fakulteteve dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësive/departamentit të financës, frekuentimin e shkollës për studentët që përfitojnë bursë.

12. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për vitin e ri shkollor 2010-2011, të japë 1950 (një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) bursa për nxënësit dhe 1600 (një mijë e gjashtëqind) bursa për studentët, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

13. Efektet financiare të vitit shkollor 2010-2011 të përballohen nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës për vitin 2010, për pjesën e vitit 2010, si dhe nga Buxheti i Shtetit që do të miratohet për vitin 2011, për pjesën e vitit 2011.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për vitet e para, është data 15 dhjetor 2010, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitet e dyta e lart është data 15 nëntor 2010.

15. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, për raste të veçanta, kur vendimet e këshillave të njësive të pushtetit vendor dërgohen jashtë afatit të përcaktuar në këtë vendim, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të rivendosë në afat përfitimin e bursës për nxënësin/studentin.

16. Vendimet e njësive të pushtetit vendor dhe ato të institucioneve të arsimit të lartë publikohen për komunitetin, median dhe institucionet e tjera vendore apo qendrore.

17. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Pasqyra nr.1

**KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT DHE STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS
(VITI MËSIMOR 2010-2011)**

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmë bursa	Me pagesë
	Për qytetin	Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë
1	Për familjet me 2 persona	Deri 3200	3200-4600	Mbi 4600
2	Për familjet me 3 persona	Deri 3100	3100-4500	Mbi 4500
3	Për familjet me 4 persona	Deri 3000	3000-4400	Mbi 4400
4	Për familjet me 5 persona	Deri 2900	2900-4300	Mbi 4300
5	Për familjet me 6 persona	Deri 2800	2800-4200	Mbi 4200
6	Për familjet me 7 persona	Deri 2700	2700-4100	Mbi 4100
7	Për familjet me 8 persona	Deri 2600	2600-4000	Mbi 4000

Shënim. Nxënësit dhe studentët nga fshati përfitojnë bursë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike, në varësi të masës së kësaj ndihme, brenda planit të akorduar për secilën njësi të pushtetit vendor.

Pasqyra nr.2

NIVELI I BURSËS PËR NXËNËSIT (VITI MËSIMOR 2010-2011)
lekë

Në

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga nxënësi	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	a) Bursa	5,963	200	6,163	0	6,163
	b) Gjysmë bursa	5,963	200	6,163	3,082	3,082
	c) Me pagesë	5,963	200	6,163	6,163	0
2	Shkolla e Mjeshtresë Sportive dhe Arsimit Special					
	a) Bursa	6,463	200	6,663	0	6,663
	b) Gjysmë bursa	6,463	200	6,663	3,332	3,332
	c) Me pagesë	6,463	200	6,663	6,663	0
3	Nxënësit jetimë	6,463	200	6,663	0	6,663

Pasqyra nr.3

NIVELI I BURSËS PËR STUDENTËT (VITI MËSIMOR 2010-2011)
lekë

Në

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga nxënësi	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	Universitetet, Akademia e Arteve dhe shkollat e tjera të larta					
	a) Bursa	6670	2000	8670	0	8670
	b) Gjysmë bursa	6670	2000	8670	4335	4335

	c) Me pagesë	6670	2000	8670	8670	0
2	Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve					
	a)Bursa	7170	2000	9170	0	9170
	b)Gjysmë bursa	7170	2000	9170	4585	4585
	c)Me pagesë	7170	2000	9170	9170	0

Pasqyra nr.4

**KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE
(VITI MËSIMOR 2010-2011)**

Nr.	EMËRTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera ditore
1	Bukë	gram	400	1117	83	33
2	Makarona	“	30	107	51	2
3	Oriz	“	30	109	82	2
4	Sheqer	“	40	157	78	3
5	Fasule	“	30	93	184	6
6	Perime	“	130	27	120	16
7	Fruta	“	100	42	108	11
8	Vaj	“	30	270	234	7
9	Gjalpë	“	20	152	531	11
10	Mish	“	90	130	620	56
11	Djath	“	25	40	352	9
12	Reçel	“	20	93	332	7
13	Vezë	kokërr	1	42	12	0
14	Qumësht	gram	200	98	40	8
15	Patate	“	200	170	85	17
16	Nënprodukte mishi	“	30	100	413	12
	Kuota ditore			2746		199

Shënim. Çmimi mesatar është indeksuar me normën mesatare të inflacionit, viti 2009.

Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menuve të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga

konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

Pasqyra nr.5

KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E
STUDENTËVE (VITI MËSIMOR 2010-2011)

Nr.	EMËRTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera ditore
1	Bukë	gram	400	1117	83	33
2	Makarona	“	30	107	51	2
3	Oriz	“	40	145	82	3
4	Sheqer	“	40	157	78	3
5	Fasule	“	40	124	184	7
6	Perime	“	130	27	120	16
7	Fruta	“	100	42	108	11
8	Vaj	“	40	360	234	9
9	Gjalpë	“	20	152	531	11
10	Mish	“	98	140	620	61
11	Djath	“	42	66	352	15
12	Reçel	“	44	190	332	15
13	Patate	“	200	170	85	17
14	Qumësht	“	200	98	40	8
15	Vezë	kokërr	1	42	12	0
16	Nënprodukte mishi	gram	30	100	413	12
	Kuota ditore			3037		222

Pasqyra nr.6

KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES (VITI MËSIMOR 2010-2011)

Nr.	Emërtimi	Kuota financiare në lekë e veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7000 (shtatë mijë) lekë
2	Për jetimët	10 000 (dhjetë mijë) lekë